



Mbikëqyrësi i Shkollave

15 korrik 2021

Përhëndetje prindër, familje dhe nxënës të Rajonit Shkollor të Filadelfias,

Shpresoj se jeni duke shijuar një verë zbavitëse dhe relaksuese. Po ju shkruaj që t'ju njoftoj se ne po punojmë shumë me përgatitjet për t'u uruar mirëseardhjen nxënësve në shkollë fizikisht për mësim, pesë ditë në javë, duke filluar të martën, më 31 gusht 2021 – *ditën e parë të shkollës*.

Shëndeti dhe mirëqenia e nxënësve dhe stafit tonë mbetet përparësia jonë më e madhe. Për këtë arsye gjatë gjithë verës, ne:

- **Po instalojmë një pastrues ajri dhe sipërfaqesh në çdo hapësirë mësimore në çdo shkollë**

Këta pastrues ajri nga më modernët bazohen në teknologji të zhvilluar nga NASA (Administrata Kombëtare e Aeronautikës dhe Hapësirës) dhe kanë treguar se mund t'i ulin ndotësit në mënyrë të jashtëzakonshme në ajër dhe mbi sipërfaqe.

- **Po pastrojmë dhe dezinfektojmë çdo shkollë**

Kjo përfshin të gjitha muret, dyshemetë, mobiljet, dyert, dritaret, banjat, parmakët e të tjera. Me fillimin e shkollës, ekipe pastrimi do të pastrojnë gjatë ditës së shkollës dhe për disa orë pas mbarimit të ditës së shkollës.

- **Po testojmë më shumë se 1000 stacione hidratimi pa prekje në shkollat tona**

Ne duam të sigurohemi që ato të jenë plotësisht në funksionim dhe në përputhje me të gjitha rregullat për ujë të sigurt për pirje.

- **Po kujdesemi për stacionet pa prekje për dezinfektimin e duarve**

Ne do t'i rimbushim stacionet në çdo shkollë dhe do të sigurojmë që të gjitha shkollat të kenë materialet që i nevojiten për të mbështetur larjen e shpeshtë të duarve nga nxënësit dhe stafi.

- **Po vazhdojmë të heqim asbetin nga shkollat tona**

Kemi hequr sasinë e barabartë me më shumë se 20 milje (32.2 km) materiale me përmbajtje asbesti nga shkollat tona që prej verës së kaluar. Tani po heqim aktivisht më shumë materiale të tilla nga 35 shkolla në të cilat projekte mjedisore dhe kapitale janë në proces e sipër.


- **Po investojmë më shumë se 160 milion dollarë për të përfunduar ndërtime, restaurime dhe riparime të mëdha të shkollave**

Kjo përfshin ndërrimin e çative, përmirësimin e sistemeve elektrike, përmirësimin e klasave, ndërrimin e sistemeve të ngrohjes dhe ajrosjes, përfundimin e ndërtimit të dy shkollave të reja e të tjera.

Pyetja e madhe që po pyesin të gjithë është: *çfarë masash shëndetësore dhe sigurie do të kërkojnë kur të rihapet shkolla?* Më 9 korrik, Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) nxorrën të përditësuara [Udhëzimet për parandalimin e COVID-19-ës në shkollat kopsht \(K\)-12](#), të cilat i japin përparësi kthimit të sigurt të të gjithë nxënësve fizikisht në mësim me disa shtresa sigurie të vëna në vend. Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë dhe Departamenti i Shëndetit Publik të Pensilvanisë aktualisht po rishikojnë udhëzimet e CDC-së së bashku me kushtet lokale të COVID-19-ës. Ata nuk kanë nxjerrë ende udhëzime të përditësuara të sigurisë për shkollat e Filadelfias por janë të përkushtuar që ta bëjnë një gjë të tillë së shpejti. Ne do t'ju përditësojmë kur ata ta bëjnë këtë gjë.

Më shumë punë po bëhet këtë verë dhe ne do të ndajmë informacion me ju rregullisht që ju të jeni po aq besimplotë dhe të entuziazmuar sa edhe ne për kthimin e fëmijës suaj fizikisht në mësim. Mund të vizitoni gjithashtu [philasd.org/ringthebell](http://philasd.org/ringthebell) për përditësimet më të fundit.

Ndërkohë, ju lutemi kujdesuni për veten dhe shijojeni verën!



William R. Hite Jr., Ed.D.  
Mbikëqyrësi i Shkollave  
Rajoni Shkollor i Filadelfias